



- Të Reja ▾ Policia e Shtetit ▾ Historik i shkurtër i Policisë së shtetit shqiptar Shërbime ▾ Baza ligjore Vendndodhjet e policisë Video
- Programi i transparencës ▾ Kontakt Denonco Krimin Kibernetik Drejtoritë Vendore të Policisë ▾ Policia Kufitare ▾ Policia Rrugore ▾
- Donacione Rubrika Policimi në Komunitet ▾ Përmbledhja Javore Për sinjalizimin

Breaking News:

Raporti i ngjarjeve, 5 janar 2024
DVP Korçë/Vihet në pranga 1 shtetas dhe procedohet në gjendje të lirë 1 tjetër, për vepra penale të ndryshme
Sarandë – Policia parandalon një ngjarje të rëndë kriminale
DVP Elbasan/Vihet në pranga 1 shtetas dhe procedohen në gjendje të lirë 6 të tjerë, për vepra të ndryshme penale
DVP Dibër/Arrestohet në flagrancë një shtetas dhe procedohet penalisht një tjetër, për vepra të ndryshme penale



Lajmet

05/01/2024

Sarandë – Policia Parandalon Një Ngjarje Të Rëndë Kriminale

/ armë

Sarandë

Parandalohet një ngjarje e rëndë kriminale, falë inteligjencës policore dhe reagimit në kohë të shërbimeve të Policisë.

Të armatosur me armë zjarri pistoletë, me qëllim rrëmbimin e një 49-vjeçari, kapen në flagrancë dhe vihen në pranga 4 shtetas.

Sekuestrohen 1 armë zjarri pistoletë, municion luftarak, automjeti dhe lidhëse plastike që do të përdoshin për këtë ngjarje.

Falë inteligjencës policore dhe si rezultat i hetimeve të thelluara që po kryhen intensivisht në kuadër të operacionit policor të koduar "Sundimi i ligjit", për të zbardhur ngjarjet kriminale të ndodhura së fundi dhe për të parandaluar ngjarje të tjera të mundshme kriminale, shërbimet e Komisariatit të Policisë Sarandë, duke vlerësuar edhe informacionet e siguruara nga inteligjenca policore, kanë parandaluar një ngjarje të mundshme kriminale.

Ditën e djeshme, në rrugën "Skënderbeu", në lagjen nr.1, shërbimet e Komisariatit të Policisë Sarandë, pas adiministrimit të informacionit, kanë ndërhyrë menjëherë duke ndaluar automjetin tip "BMW", me drejtues shtetasin A. T. dhe pasagjerë shtetasit J. B. dhe S. B. (vëllezër) dhe Gj. P.

Gjatë kontrollit në automjet, në vendin e pasagjerit ku qëndronte shtetasi J. B., shërbimet e Policisë gjetën 1 armë zjarri pistoletë dhe lidhëse plastike, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Në vijim të veprimeve procedurale u arrestuan në flagrancë shtetasit J. B., 28 vjeç, S. B., 27 vjeç, A. T., 20 vjeç dhe Gj. P., 29 vjeç, për veprat penale "Heqja e paligjshme e lirisë", mbetur në tentativë, kryer në bashkëpunim dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyes dhe municionit luftarak".

Këta shtetas dyshohet se në kërcënimin e armës do të rrëmbenin një shtetas 49 vjeç, banues në Sarandë, për motive të dobëta.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

angazhimpërkushtimsakrificë

tëvendosurkundërkrimittë

nëçdoskajtëvendittë

nëshërbimtëqytetarëve

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ DVP Elbasan/Vihet në pranga 1 shtetas dhe procedohen në gjendje të lirë 6 të tjerë, për vepra të ndryshme penale

DVP Korçë/Vihet në pranga 1 shtetas dhe procedohet në gjendje të lirë 1 tjetër, për vepra penale të ndryshme ▶

You May Also Like



Vlorë. Goditet një tjetër rast për armëmbajtje pa leje dhe lëndëve narkotike

24/04/2019 0